



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova Komuna e
Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

**Thirrje për Organizatat Joqeveritare (OJQ)
Kulturore dhe Rinore, për organizimin e
aktiviteteve në fushën e kulturës dhe rinisë në
Komunën e Podujevës**

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 18.03.2025

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:
08.04.2025

Përmbajtja

1. Mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në fushën e Kulturës dhe Rinisë	2
1.1 Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike.....	3
1.2. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve.....	3
1.3 Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet në kuadër të thirrjes publike	4
2. Kushtet formale të thirrjes.....	4
2.1 Kush nuk ka të drejtë të konkurroj sipas kësaj thirrje?.....	4
2.2 Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit apo aktivitetit	5
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:	5
2.4 Cilat programe, projektet apo aktivitete nuk do të financohen?.....	6
2.5 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes publike	7
2.5.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme	7
2.5.2 Shpenzimet e papranueshme	7
3. Si të aplikoni?.....	8
3.1 Projekt-Propozimit	8
3.2 Propozim-Buxheti	8
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?	9
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve.....	9
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?	9
4. Vlerësimi dhe ndarja e fondeve.....	9
4.1 Vlerësimi i aplikacioneve	9
4.2 Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi	10
5. Njoftimi i aplikantëve.....	10

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport mbështet financimin e projekteve, programeve dhe aktiviteteve kulturore dhe rinore që kontribuojnë në zhvillimin e jetës kulturore, fuqizimin dhe pluralizmin e aktiviteteve rinore dhe rritjen e cilësisë së jetës përmes kulturës dhe rinisë. Projektet mund të jenë në fusha të ndryshme si: festivale, aktivitete artistike dhe kulturore; trajnime dhe edukim joformal; aktivitete për të rinjtë (punëtori, kampe, vullnetarizëm); promovim i trashëgimisë kulturore dhe turizmit; dhe teknologji, shkencë dhe shëndet mendor.

1.1 Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nëpërmjet thirrjes publike mëton të adresoj problemet si: prioritetin për pluralitetin dhe fuqizim të aktiviteteve kulturore dhe rinore në Komunën e Podujevës; prioritetin për fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes; prioritetin për zhvillimin dhe promovimin e jetës kulturore, duke përfshirë artin, kinematografinë dhe vallëzimin; prioritetin për promovimin e trashëgimisë kulturore; prioritetin për fuqizimin dhe zhvillimin e edukim joformal dhe zhvillim të shkathtësive të të rinjve; fuqizimin e vullnetarizmit dhe angazhimit qytetar të të rinjtë; fuqizimin e vetëdijesimit për shëndetin mendor; zhvillimin dhe promovimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit; dhe prioritetin për forcimin e mendimit kritik dhe multikulturalizmit;

1.2. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përcaktuar objektivat në kuadër të thirrjes publike, të cilat janë: hartimi, planifikimi dhe zbatimi i programeve/aktiviteteve rinore që adresojnë nevojat e të rinjve dhe nxisin zhvillimin e tyre; zhvillimi dhe promovimi i jetës kulturore në komunë; organizimi i festivaleve, panairove dhe manifestimeve kulturore; ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore; fuqizimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje; rritja e njohurive dhe aftësive përmes edukimit joformal; nxitja e vullnetarizmit të të rinjtë; fuqizimi i mendimit kritik; promovimi i shkencës, teknologjisë dhe ambientit; rritja e vetëdijes për shëndetin mendor; dhe nxitja e multikulturalizmit dhe bashkëpunimit kulturor e rinor.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përcaktuar prioritetet për ndarjen e fondeve, të cilat janë: projektet që janë në përputhje me objektivat e mësipërme; projektet që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin kulturor dhe rinor në Komunën e Podujevës; projektet që ofrojnë aktivitete konkrete dhe me ndikim në komunitet; projektet që fuqizojnë të rinjtë përmes pjesëmarrjes, edukimit dhe angazhimit aktiv; projektet që promovojnë kreativitetin, 3

inovacionin dhe diversitetin kulturor; dhe projektet që trajtojnë çështje me rëndësi si teknologjia, ambienti dhe shëndeti mendor.

1.3 Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet në kuadër të thirrjes publike

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përcaktuar vlerën 40.000 euro për mbështetje financiare për programet, projektet apo aktivitetet në fushën e Kulturës dhe Rinisë.

2. Kushtet formale të thirrjes

Kushtet formale të thirrjes publike janë:

- a) OJQ-të duhet të veprojnë në Republikën e Kosovës;
- b) Projektet duhet të zhvillohen në Komunën e Podujevës;
- c) OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;
- d) OJQ-të që nuk kanë përmbyllur raportet e subvencioneve të viteve të kaluara nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet në këtë thirrje;
- e) Të mos kenë pranuar mjete nga burime të tjera për të njëjtat aktivitete;
- f) Projektet duhet të reflektojnë objektivat dhe kriteret e thirrjes publike;
- g) Të mos ekzistojë konflikt interesi mes aplikuesit dhe institucioneve publike ose organizatave buxhetore.
- h) Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- i) Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit.

2.1 Kush nuk ka të drejtë të konkurroj sipas kësaj thirrje?

Sipas thirrjes publike, nuk kanë të drejtë të konkurrojnë:

- a) OJQ-të që nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake;
- b) OJQ-të që kanë pranuar mjete nga burime të tjera financimi për të njëjtat aktivitete;
- c) OJQ-të që kanë marrë subvencione nga Komuna e Podujevës për më shumë se një projekt brenda një viti, edhe në kategori të ndryshme;
- d) Aplikuesit që ekziston konflikt interesi mes tyre dhe institucioneve publike ose organizatave buxhetore;
- e) OJQ-të e falimentuara.

2.2 Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit apo aktivitetit

- a) Organizata ose institucione të tjera OJQ që bashkëpunojnë dhe e cila ushtron aktivitetin në Komunën e Podujevës;
- b) Partnerët duhet të jenë të përfshirë formal në projekt dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara;
- c) Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë sipas pikës 2 të Udhëzuesit;
- d) Aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere, për të cilën duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, të cilën duhet dorëzuar gjatë fazës së aplikimit.

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

Sipas thirrjes publike aktivitetet e pranueshme që mund të financohen janë:

1. Kinematografi – projekte filmi, festivale apo dokumentarë.
2. Vallëzim.
3. Aktivitete dhe manifestime për shënimin e datave të rëndësishme në Komunën e Podujevës.
4. Art në hapësira publike.
5. Promovim të turizmit kulturor.
6. Festivale lokale – muzikë, teatër, film dhe art bashkëkohor.
7. Trajnime për art, dizajn, muzikë dhe film.
8. Panairë libri.
9. Panairë në artin tradicional, trashëgimi kulturore dhe punime artizanale.
10. Panairi i punës.
11. Promovim të trashëgimisë kulturore.
12. Edukimi joformal.
13. Aktivitete argëtuese për fëmijë.
14. Punëtori me të rinjtë.

15. Kampe rinore.
16. Vullnetarizëm.
17. Trajnime për lidërsnip dhe pjesëmarrje qytetare.
18. Fuqizim i pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
19. Programe për zhvillim të shkathtësive (soft skills).
20. Shkencë dhe digjitalizim.
21. Vetëdijësim dhe mendim kritik.
22. Çiklizëm, ecje dhe vrapim.
23. Ambient dhe teknologji.
24. Teknologjia dhe njeriu.
25. Programe/aktivitetet mbi ndërgjegjësimin për shëndetin mendor.
26. Programe/aktivitetet mbi multikulturalizmin.
27. Të tjera programe dhe aktivitete në fushën e kulturës dhe rinisë.

Në thelb, çdo aktivitet që kontribuon në zhvillimin rinor, kulturor, edukativ, shëndetësor ose multikultural në Podujevë është i pranueshëm, brenda buxhetit dhe objektivave të thirrjes.

2.4 Cilat programe, projektet apo aktivitete nuk do të financohen?

Sipas thirrjes publike, aktivitetet që nuk janë të pranueshme për financim janë të implikuara nga kushtet e përgjithshme. Programet, projektet apo aktivitete që nuk do të financohen janë:

- 1) Nuk përputhen me objektivat e thirrjes për kulturë dhe rini.
- 2) Janë financuar nga burime të tjera për të njëjtat aktivitete.
- 3) Janë pjesë e projekteve të OJQ-ve që nuk kanë përmbushur raportet e subvencioneve të viteve paraprake.
- 4) Krijojnë konflikt interesi mes aplikuesit dhe institucioneve publike ose organizatave buxhetore.
- 5) Janë projekte që nuk zbatohen brenda territorit të Komunës së Podujevës.
- 6) Janë projekte për të cilat OJQ-të kanë marrë subvencione më shumë se një herë brenda vitit, edhe në kategori të ndryshme.

- 7) Aktivitetet që nuk mund të dokumentohen ose raportohen sipas kërkesave (raporti narrativ dhe financiar).

Pra, në thelb, nuk financohen aktivitete që shkelin rregullat e thirrjes, nuk janë të lokalizuara në Podujevë, ose janë të njëjta me projekte të financuara më parë.

2.5 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes publike

Shpenzimet e projektit/programit apo aktivitetit duhet që të jenë në përputhje me shpenzimet reale për zbatimin e tyre duke maksimizuar përfitimin për komunitetin.

2.5.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme janë ato që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit/programit ose aktivitetit. Shuma e kërkuar duhet të reflektojë nevojat reale të aktivitetit, duke mbuluar shpenzimet e drejtpërdrejta për zbatimin e projektit (materiale, pajisje, transport, honorare, promovim, dokumentim) pa tejkalluar buxhetin maksimal të përcaktuar sipas thirrjes publike.

2.5.2 Shpenzimet e papranueshme

Sipas thirrjes publike të Komunës së Podujevës, shpenzimet e papranueshme janë ato që nuk lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit/programit ose aktivitetit apo shpenzimet që nuk janë në përputhje me kriteret e thirrjes. Rrjedhimisht nuk do të financohen:

- 1) Shpenzime që nuk lidhen me aktivitetin e projektit - blerje të mallrave ose shërbimeve që nuk përdoren për realizimin e aktiviteteve rinore ose kulturore.
- 2) Shpenzime të financuara nga burime të tjera për të njëjtat aktivitete - nuk pranohen shpenzime që janë subvencionuar ose financuar nga donatorë të tjerë për të njëjtin qëllim.
- 3) Shpenzime administrative të përgjithshme që nuk janë të drejtpërdrejta - qira zyre që nuk lidhet me aktivitetin, shpenzime për energji, ujë, internet nëse nuk lidhen me projektin, ose paga të stafit që nuk përfshihet direkt në aktivitet.
- 4) Shpenzime jashtë buxhetit minimal/maksimal të projektit - shuma e kërkuar duhet të jetë midis 300 € dhe 3,000 €. Çdo shpenzim që tejkallon këtë kufi nuk është i pranueshëm.
- 5) Shpenzime pa dokumentacion ose të papërrputhshme me legjislacionin - çdo shpenzim që nuk mund të dëshmohet me faturë, kontratë apo dokument tjetër zyrtar.

- 6) Shpenzime që krijojnë konflikt interesi - pagesa ose transaksione që përfshijnë përfaqësues ose familjarë të aplikuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë që mund të ndikojnë në vendimmarrje.

3. Si të aplikoni?

- 1) Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- 2) Certifikata e nr. fiskal;
- 3) Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së;
- 4) Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- 5) Vërtetimin që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- 6) Deklarata për financimin e dyfishtë (nëse ka);
- 7) Deklarata e partneritetit; (nëse ka);
- 8) Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike;
- 9) Formulari i propozim-buxhetit.

3.1 Projekt-Propozimit

Projekt-propozimi ka një rol kyç në aplikimin për thirrjen publike, pasi ai paraqet në mënyrë të strukturuar idenë e projektit, objektivat, aktivitetet dhe buxhetin, duke mundësuar vlerësimin e përshtatshmërisë dhe ndikimit të tij nga Komuna e Podujevës. Ai është dokumenti kryesor që tregon rëndësinë dhe ndikimin e projektit në zhvillimin rinor, kulturor dhe komunitar, duke lidhur aktivitetet konkrete me qëllimet e thirrjes. Projekt-propozimi përmban informacionet e përgjithshme të OJQ-së, përshkrimin e projektit, objektivat specifike, grup-objektivët, aktivitetet kryesore, rezultatet e pritura, si dhe dokumentacionin shoqërues dhe deklaratat për partneritet ose financim të dyfishtë, duke siguruar që aplikimi të jetë i plotë dhe i pranueshëm për shqyrtim.

3.2 Propozim-Buxheti

Propozim-buxheti ka një rol thelbësor në aplikimin për thirrjen publike, pasi ai tregon në mënyrë të qartë dhe të detajuar shpenzimet e projektit dhe mënyrën e përdorimit të fondeve. Propozim-buxheti është i rëndësishëm sepse siguron që çdo shpenzim të jetë i drejtpërdrejtë, i bazuar në nevojat reale të aktivitetit dhe në përputhje me kufijtë e thirrjes, duke maksimizuar ndikimin e projekteve të financuara. Propozim-buxheti përmban detajet e shpenzimeve të pranueshme si materialet, pajisjet, transporti, honoraret, promovimi dhe dokumentimi, si dhe

çdo shpenzim tjetër që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e projektit, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie për fondet e alokuara.

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Dokumentet e kompletuara duhet të vendosen në zarf dhe të dorëzohen në: Ndërtesa e Komunës së Podujevës, Rr. Nuhi Gashi, në Zyrën për Shërbim të Qytetarëve. Në zarf duhet të shkruhet: *Aplikim në kuadër të Thirrjes për Projekt-Propozime për vitin 2026.*

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i fundit për dërgimin e aplikacionit është me datën 08.04.2026

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: jakup.gashi@rks-gov.net dhe omer.kosumi@rks-gov.net ose në hapësirat e DKRS në objektin e Komunës.

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen jo më vonë se 8 ditë para skadimit të thirrjes.

4. Vlerësimi dhe ndarja e fondeve

Sipas thirrjes publike të Komunës së Podujevës, vlerësimi dhe ndarja e fondeve bëhet në mënyrë të strukturuar dhe transparente, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren për subvencione.

4.1 Vlerësimi i aplikacioneve

Aplikacionet shqyrtohen për plotësinë e dokumentacionit, përputhshmërinë me objektivat e thirrjes dhe kriteret e përgjithshme. Çdo projekt vlerësohet sipas përshtatshmërisë së tij me objektivat e rinisë dhe kulturës, ndikimit të pritshëm, realizueshmërisë dhe buxhetit të propozuar.

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në dy faza:

Faza e parë: Komisioni, i përbërë nga 5 anëtarë (zyrtarë komunal dhe ekspertë të jashtëm) do të vlerësojnë nëse aplikimi është në përputhje me kriteret formale të thirrjes publike. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, do të bëhet klasifikimi i atyre që i plotësojnë dhe nuk i plotësojnë kriteret formale. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale do të njoftohet me 9 shkrim mbi arsyet e refuzimit.

Faza e dytë: Komisioni, i përbërë nga 5 anëtarë (zyrtarë komunal dhe ekspertë të jashtëm) do të vlerësojnë përmbajtjen e aplikacioneve nëse janë në përputhje me frymën e thirrjes publike. Vlerësimi do të bëhet në përputhje me formularin për vlerësimin e aplikacioneve.

Komisioni do të përpunoj listën e përkohshme si dhe listën rezervë.

4.2 Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi

Komuna e Podujevës do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga kandidatët të cilët pas procesit të vlerësimit vendosen në listën e përkohshme. Nëse aplikantët nuk i dorëzojnë dokumentacionet shtesë gjatë afatit kohor prej 10 ditë, aplikimi i tyre do të refuzohet.

Komuna e Podujevës, para nënshkrimit të kontratës me përfituesit ka të drejtë të shqyrtoj dhe vlerësoj buxhetin e propozuar për programet/projektet apo aktivitetet e përcaktuara.

Pas përfundimit të procedurave të vlerësimit dhe plotësimit të dokumentacionit, Komisioni do të propozoj projektet/programet dhe aktivitetet e përzgjedhura për financim.

5. Njoftimi i aplikantëve

Të gjithë aplikantët do të njoftohen për vendimet mbi aplikimet e tyre.